

Dr. Ornela Arapi

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit – AIDSSH

Bio

Dr. Ornela Arapi ka lindur më 10 prill 1982, në Dibër. Prej muajit janar 2023 mban pozicionin e Drejtorit të Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, duke kontribuar në mbështetjen e rishikimit historik të veprimtarisë së Ish-Sigurimit të Shtetit.

Dr. Arapi është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe mban titullin “Përkthyes e gjuhës italiane”. Në vijim ajo fitoi licensën e përkthyeses zyrtare, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Znj. Arapi është doktore shkencash në fushën shkencave sociale dhe të komunikimit. Me përfundimin e studimeve, ka qenë pedagoge pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, për një periudhë dhjetëvjeçare. Ajo ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e komunikimit politik dhe ndërkulturor.

Që prej vitit 2018 është angazhuar me pjesëmarrje aktive në trajtime, seminare dhe leksione në fushën e trajtimit të dokumenteve të krijuara nga Politikë Sekrete, në fushën e kujtesës dhe edukimin e brezave të rinj me njohjen e të vërtetave historike, veprimtarinë e kryer nga Ish-Sigurimi i Shtetit gjatë periudhës komuniste në vend, të cilën e konsideron si një domosdoshmëri, që lidhet jo vetëm me njohjen e historisë, por edhe edukimit me parime bazë të etikës, me vlerat e mendimit intelektual, prej të cilave diktatura u përpoq ta privonte kombin, përmes asgjësimit të personaliteteve të forta të vendit.

Disa nga detyrat dhe funksionet e Drejtorit të Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar: Në bazë të kalendarit të kujtesës, planifikon dhe i propozon institucionit të Autoritetit, aktivitetet dhe projektet afatgjata dhe afatshkurtra, të cilat vënë në fokus kërkimin shkencor mbi rolin dhe funksionimin e ish-Sigurimit në shtet dhe shoqëri, edukimin qytetar të brezave të rinj dhe njohjen e tyre me të shkuarën e vendit, si dhe ndjek e drejton punën për realizimin e tyre, përmes grupeve të punës dhe komunikimit me të tretët; ▪ Mbikëqyr dhe merr pjesë në studimet shkencore për format e ndryshme të shfaqjes dhe ekzistencës së opozitës, rezistencës, përndjekjes dhe kryengritjes ndaj regjimit komunist ▪ Koordinon punën për përgatitjen e botimeve të institucionit, apo me partnerë të tjerë; ▪ Drejton punën dhe kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të mbledhjes dhe botimit të dëshmimeve gojore;

Konferenca dhe botime:

▪ Capodicasa G., Përkthim, Tit. Orig. “Parvenze Circolari”, 1998 Piero Manni, Lecce, Itali, Përkthimi në shqip “Vorbull Endrrash”, Accustica Edizioni, Lecce, Itali.

- The art of using insults (Fokusi - Diskursi politik); Artikull i botuar në revistën “AKTET” (Revistë shkencor e Institutit Alb-Shkenca). ISBN: 978-9928- 110-34-3
- Konferencë Ndërkombëtare e Institutit Shqiptar të Sociologjisë; Artikull i botuar në Proceedings: “Political linguistic aggression” (perspektivë psikologjike). ISBN: 978-9928-4152-4-0
- Progressive Academic Publishing; European Journal of Research and Reflection in Arts and Humanities “Political communication and the Albanian political communication” Vol. 3, ISSN: 2056- 5887
- Le CS&SS International e-Conference in Science and Social Science: “Political discourse and the discourse of political leaders” ISSN: 114-968
- Summer e-Conference 2015; Article published in Proceedings: “Personal qualities of leadership”. ISSN: 177- 423
- Skap e-conference, “Personal qualities of leadership” ISBN 92-849-0892-0
- Budapest/Hungary: The Application of the General Data Protection Regulation (GDPR) in Archives, with Special Focus on the Documents of Totalitarian Political Systems.: Approach and application of the “Albanian Personal Data Protection Law” on the documents of the Former State Security Services;
- Tirana/Albania: “Reporting on the SIGURIMI files & researching in archives” - Workshop;
 - The struggle for the opening of the Albanian files. Challenges on file’s application etc.
- Krzyżowa/Poland: 17th East-West-European Memorial Seminar Forgotten History-Forgotten places - forgotten names - forgotten events: Dealing with repressed aspects of history. (Un)forgotten places: Tepelena’s Camp- The so-called Auschëitz of Albania
- Krakow/Poland: 10th European Workshop in Auschwitz; Maximilian-Kolbe-Foundation; European Workshop on the topic "Dealing with the past of Auschwitz burdened by violence"